

VENDIM
Nr. 337, datë 23.4.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar”.

b) Pikat 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit në masën 3 975 401 851 (tre miliardë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e katërqind e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak e Vorë.”.

c) Në pikat 2 dhe 3, vlera “... 1 088 094 042 (një miliard e tetëdhjetë e tetë milionë e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH ...” ndryshohet dhe bëhet “... 795 080 370 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH ...”, miratuar në buxhetin e vitit 2020.

2.Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama